



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Nr. 1633 / Prot.  
2

Lënda: Dërgim rezolute

Tiranë më 20.07.2022

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ






REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

Lindita NIKOLLA



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR  
PËR VITIN 2021

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke nënvizuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor,

**Vlerëson:**

Procesin e kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë;

Punën e kryer për hartën e re gjyqësore në bashkëpunim mes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e propozimit të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave sipas parashikimeve të nenit 13 të

ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke konstatuar se procesi ka marrë shumë kohë dhe se miratimi i hartës së re gjyqësore përveçse është një detyrim ligjor, përbën një hap të rëndësishëm për mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor.

Punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për hartimin dhe miratimin e një serie aktesh nënligjore normative dhe rregullatore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera të reformës në drejtësi, si dhe rëndësinë e përmbylljes së paketës së plotë të këtyre akteve sa më parë.

Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar dhe rëndësinë e kryerjes së këtij procesi në një kohë sa më të arsyeshme.

Analizat e kryera për shumë aspekte të sistemit gjyqësor referuar edhe standardeve të Komisionit Europian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ), mbarëvajtjen e punës në gjykata dhe masat e marra në këtë drejtim.

Punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor në propozimin dhe administrimin e buxhetit të vet dhe të gjykatave në përputhje me nevojat përkatëse.

Kontributin e dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor përmes opinioneve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimit e tij.

### **Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2021, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:**

Zhvillimin e 100 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 607 vendimeve për vitin 2021.

Plotësimin e Gjykatës së Lartë me 9 anëtarë dhe hapjen e garës për të gjitha vendet e mbetura vakante përmes procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratëve gjyqtarëve.

Finalizimin e propozimit të përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë të hartës së re gjyqësore dhe organizimin e konsultimeve publike me palët e interesuara.

Vijimin e zbatimit të reformës së administratës civile gjyqësore nëpërmjet rekrutimit dhe shpërndarjes së 86 nëpunësve gjyqësorë në gjykata, përfundimit të verifikimit të kriterëve ligjore, pasurisë dhe integritetit për 2/3 e kancelarëve në detyrë, si dhe verifikimit dhe pranimit në shërbim civil gjyqësor të 17 punonjësve, nga të cilët 7 këshilltarëve ligjorë pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë dhe 10 ndihmësligjorë në gjykatat e apeleve.

Përcaktimin e numrit të kuotave në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2021-2022, plotësimin me 35 kandidatë për magjistratë në profilin gjyqtar dhe 20 kandidatë në profilin këshilltarë dhe ndihmësligjorë, për të cilët u krye edhe verifikimi i kriterëve formale-ligjore, pasurisë dhe figurës për 26 kandidatë.

Vijimin e bashkëpunimit të ngushtë me organet e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve nëpërmjet depozitimit pranë KPK-së të 70 raporteve të analizimit të aftësive profesionale të shoqëruara me 350 dosje gjyqësore për 70 subjekte (gjyqtarë) të rivlerësimit kalimtar.

Ushtimin e kompetencave lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, me qëllim vetëpastrimin e sistemit gjyqësor nëpërmjet zhvillimit të 10 procedimeve disiplinore.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore në gjykata, trajtimin e 744 kërkesave duke caktuar 920 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme ose 5% më shumë se vitin e shkuar, si dhe përfshirë në skemë delegimi 14 gjyqtarë dhe transferuar me pëlqim 10 të tjerë.

Vazhdimin e plotësimin të paketës së akteve dhe vlerësimin etik-profesional të gjyqtarëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nëpërmjet hartimit dhe miratimit të 72 raporteve të vlerësimit (36 për periudhën e vlerësimit 2013-2016 dhe 36 për periudhën e vlerësimit viti 2019).

Përfundimin e vlerësimit për 36 gjyqtarë, duke trajtuar me prioritet kandidatët të cilët janë në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, gjykatat e posaçme dhe gjykatat e apeleve, me qëllim funksionalizimin apo ruajtjen e funksionalitetit të tyre.

Shqyrtimin e 100 ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit, nga 121 ankime të regjistruara në total, për të cilat Këshilli ka vendosur refuzimin e tyre si të pabazuar.

Marrjen e masave për përmirësimin e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve (ICMIS), me shtimin në këtë version të 37 zhvillimeve të reja, dhe duke iu përgjigjur me mbështetje teknike 667 kërkesave të gjykatave nga i gjithë vendi.

Trajtimin e 55 kërkesave në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit.

Përditësimin me informacion të faqes zyrtare të internetit me materialet dhe vendimmarrjet e Këshillit.

Hartimin dhe miratimin e rregulloreve për shqyrtimin e praktikave korruptive në KLGJ, hetimin administrativ të sinjalizimit, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ruajtjen e konfidencialitetit, në funksion të angazhimit të Këshillit për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në institucion.

Vijimin e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm duke zhvilluar një sërë aktivitete, takimesh, konferencash dhe trajnimesh me institucionet vendase, ndërkombëtare, shoqërië civile, etj..

Zhvillimin e trajnimeve në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, ASPA-n, projektet e asistencës së huaj etj., të punonjësve të institucionit, punonjësve të gjykatave dhe gjyqtarëve.

Hartimin e Planit të dytë Strategjik për periudhën 2022-2024, i cili i është nënshtruar një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimesh.

KLGG-ja ka adresuar nevojën për disa ndryshime ligjore që i shërbejnë mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë.

### **Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Këshillin e Lartë Gjyqësor:**

1. Të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin Gjyqësor, me qëllim mirëfunksionimin e sistemit në kuadër të parimit të funksionalitetit.

2. T'i kushtojë rëndësi informimit të publikut për qasjen në drejtësi dhe mbarëvajtjes së marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun.

3. Të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi.

4. Të informojë, sa herë kërkohet, Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin gjyqësor duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

### **Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor:**

1. Të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër procesin e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Lartë.

2. Të vijojë me ritme të shpejta procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Të ndjekë dhe të informojë periodikisht Kuvendin e Shqipërisë për ecurinë dhe problematikat në implementimin e hartës së re gjyqësore.

4. Të vijojë me intensitet puna për rritjen e efikasitetit të administrimit të gjykatave sipas përcaktimeve të nenit 89 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

5. Të vijojë me përparësi zbatimin e procesit të vlerësimit etik-profesional të gjyqtarëve në përputhje me skemën e re të vlerësimit.

6. Të bashkëpunohet me organet e tjera të drejtësisë për nevojat e aksesit në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, për aq sa është e mundur, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe mundësitë teknike.

7. Me qëllim përmbushjen e përcaktimeve ligjore, të organizohen takime të përbashkëta periodike me Këshillin e Lartë të Prokurorisë duke e vendosur theksin në unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjeve.

8. Të përshpejtojë ritmet e punës për vlerësimin vjetor të performancës së personelit të administratës së gjykatës.

9. Të përmbyllë miratimin e të gjitha akteve nënligjore që përcaktohen në ligjet e reformës në drejtësi.

10. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkellje.

11. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe specifikimeve të nenit 87 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të mbajë dhe të artikulojë publikisht qëndrimet përkatëse kur gjykohet se pavarësia e pushtetit gjyqësor është cenuar.

12. Të intensifikojë veprimtarinë në përmbushje të përcaktimeve për qasjen në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës të organizojnë trajnime për anëtarët e Këshillit, gjyqtarët, për mediet, administratën e Këshillit dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në këto aktivitete.

13. Të vijojë me dhënien e opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 187 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Miratuar në datën 14.7.2022